



Norma fetare (hukmi) rreth Mevludit

Description

Hatem el-Auni

Së pari, duhet të themi se çdo diskutim mbi mevludin duhet të jetë akademik dhe objektiv, dhe pa hedhur poshtë mendimet e ndryshme të dijetarëve në lidhje me të, veçanërisht duke marrë parasysh që ka dijetarë të shkëlqyer që e kanë konsideruar mevludin të rekomanduar me kushte të caktuara.

Merreni me mend, vetë shehu i Islamit, Ibn Tejmije, në veprën e tij “Iktida el-Sirat el-Mustekim”, edhe pse arrin në përfundimin se mevludi është një bidat, gjithsesi ai e justifikon atë që e kryen atë. Në fakt, ai mendon se ata do të marrin shpërblim të madh për të. Ai shprehet, “Nderimi i mevludit, marrja e tij si festë, është një veprim që disa njerëz mund të bëjnë dhe të marrin një shpërblim të madh, për shkak të qëllimit të tyre të mirë, dhe për shkak të nderimit që ata tregojnë ndaj të Dërguarit të All-llahut (a.s.). Siç ju kam sqaruar, ky është një veprim që mund të konsiderohet i mirë nga disa njerëz, ndërsa është i kundërshtueshëm për besimtarin që është qartësuar [për të vërtetën në lidhje me këtë çështje]”.

Së dyti: Norma ligjore (hukmi) në lidhje me mevludin.

Qëndrimi im është ky: Mevludi lejohet për këdo që e sheh ditën e mevludit si një mundësi për ti kujtuar njerëzit për jetën (sirah) e Profetit (a.s.), ose për të rritur dashurinë për të në zemrat e muslimanëve, me kusht që celebrimi i mevludit të jetë i shpirtor nga çdo ekstremizëm (siç është istighatha [kërkimi ndërmjetësim Profetit]), nga çështje të ndaluara (siç është përzierja e lirë e burrave dhe grave), ose nga bestytini (siç është besimi se Profeti (a.s.) merr pjesë personalisht në mevlud) si dhe pa i atribuar ditës së mevludit ndonjë virtut të veçantë. Përkundrazi, personi e merr këtë ditë si një mundësi për të përfituar nga ngjarja e rëndësishme historike e lindjes së Profetit dhe për ti përkujtuar njerëzit rreth saj, njësoj siç predikuesit u kujtojnë njerëzve Betejën e Bedrit në 17 të Ramazanit, çlirimin e Mekës në 20 të Ramazanit, dhe hixhretin e Profetit (a.s.) në fillim të vitit të Hixhrit. Kjo është e lejueshme sepse, në këtë rast, personi nuk ka bashkangjitur kësaj dite asnjë element të adhurimit. Kur mevludi kryhet në përputhje me këto kushte, hukmi i tij shkon nga nga të qenit një risi e ndaluar në një çështje të lejueshme që i përket dobisë së përgjithshme (maslaha mursala). Me këto kushte, mevludi nuk është gjë tjetër veçse një mjet për të arritur një objektiv të ligjshëm, domethënë: përkujtimi i njerëzve për jetën e Profetit (a.s.) dhe rritja e dashurisë për të në zemrat e njerëzve.

E shoh të domosdoshme të theksoj gjithmonë se ky vendim i lejueshmërisë së pjesëmarrjes dhe mbajtjes së mevludit mbështetet në pikat e mëposhtme:

- Mbajtja e mësimave ose kremtimeve për mevlud (të cilat janë të shpirtor nga elementë të ndaluar) nuk kryhen sepse mevludi është një veprim adhurimi në vetvete, por sepse ai shihet si një mjet për të shfrytëzuar datën e lindjes së Profetit (a.s.) për të arritur një objektiv të vlefshëm;
- Data kalendarike e lindjes së Profetit (a.s.) nuk ka ndonjë virtut të veçantë, të mirëpërcaktuar;
- Nevoja për të sqaruar qartë besimet, deklaratat ose praktikën e rreme që shpesh ndodhin gjatë mevludeve.

Kur përmbushen këto kushte, unë nuk e konsideroj mevludin bidat (risi në fe) dhe nuk gjej ndonjë arsye për ta refuzuar atë.

Unë, gjithashtu, nuk shoh ndonjë problem tek ata që refuzojnë të mbajnë mevlud, për hir të shmangies së problemeve dhe veseve që janë të pranishme në shumë festime të mevludit, për aq kohë sa ai që e mban këtë qëndrim nuk shkon në ekstrem. D.m.th. ata që nuk e festojnë mevludin nuk duhet ti censurojnë (inkar) ato që e konsiderojnë të lejueshëm mevludin brenda parametrave të lartpërmendur dhe e konsiderojnë vlefshëmërinë e tij një çështje të ixhtihadit të vlefshëm. Kjo pikëpamje e kundërt – me këto kushte – është një mendim i vlefshëm, dhe nuk është pa meritë.

Në praktikë, ne zbulojmë se diçka e ngjashme me këtë tashmë ndodh këtu në Arabinë Saudite pa asnjë kundërshtim. Shumë hytbe dhe vaza (predikime dhe këshilla fetare) që mbahen në xhamia kanë si temë censurimin dhe kritikimin e mevludit. Këto hytbe dhe vaza mbahen zakonisht kur afrohet data e mevludit (qoftë një xhuma para mevludit ose një natë para tij). Shumë prej predikimeve fillojnë me përmendjen e virtyteve të Profetit (a.s.) dhe të drejtat e tij mbi Umetin, dhe më pas përfundojnë duke përmendur fenomenet e liga (munkarat) që ndodhin në tubimet e mevludit. Në realitet, keta hatibë [ndonëse në mënyrë të pavetëdijshme, shën. i perk] janë duke e praktikuar mevludin, por pa e quajtur të tillë, sipas mënyrës që unë e konsideroj të lejueshme.

Diçka e ngjashme me këtë janë veprat që janë shkruar dhe vazhdojnë të shkruhen nga studiuesit selefi

rreth muajit të Ramazanit, siç është libri i Sheh Ibn Uthejminit, Zoti e mëshiroftë, i cili përmban përkujtime të Betejës së Bedrit dhe çlirimit të Mekës në datat (gjatë ramazanit) kur këto ngjarje kanë ndodhur. Uthejmini kishte për qëllim që ky libër t'u lexohej çdo vit njerëzve nëpër xhamia. Ishte shpresa e tij dhe po kështu dëshira e secilit që dëshiron të marrë vazhdimisht shpërblim për këtë që këto lexime të vazhdojnë çdo Ramazan dhe që këto të përhapen në mesin e myslimanëve. Ne hasim se kjo është në fakt ajo që ndodh në xhamitë tona për çdo vit. Të lexuarit e përsëritur në lidhje me këto dy beteja në ditë të veçanta të çdo viti nuk e bën bidat këtë praktikë, sepse specifikimi i këtyre ditëve nuk merret si një veprim adhurimi, por në kuptimin që përfitimi i kësaj date historike është më me ndikim tek dëgjuesit, i bën këto ngjarje historike më të paharrueshme, dhe shërben për të na kujtuar bekimin e madh të Zotit mbi ne në këto dy ditë të shkëlqyera në historinë e Islamit.

Si mënyrë për të marrë një qëndrim të mesëm, shumë prej atyre që bëjnë mevlud kanë përvetësuar praktikën e mos kufizimit të tubimeve të mevludit në datën vjetore të ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.). Ato i mbajnë këto mbledhje për të kujtuar virtytet e Profetit (a.s.) disa herë gjatë vitit. Për sa kohë që ato janë të lirë nga veset e shoqëruara me disa tubime mevludi, nuk ka absolutisht asgjë të keqe me mbledhje të tilla, me kusht që të mos besohet se ato janë një formë specifike e adhurimit në vetvete.

Përmbledhje

Tani është e qartë se tubimet e mevludit janë në dy kategori:

1 – Një skenar në të cilin mevludi përfshihet nën çështje të dobisë së përgjithshme (maslaha mursala): Nisur nga dëshira për të përfituar nga data e kësaj ngjarje të rëndësishme për ti kujtuar njerëzit për jetën e Profetit (a.s.) dhe për të rritur dashurinë për të në zemrat e njerëzve, pa besuar se ka një virtyt të veçantë fetar bashkangjitur me këtë datë që të justifikoj veçimin e tij me adhurim ose besime të caktuara për të cilat nuk ka argumente fetare.

Është kjo mënyra e krenimit të mevludit që u aprovua nga shumë dijetarë myslimanë, të tillë si Ebu Shema, Ibn Nasir el-Din, dhe shumë studiues të tjerë të mëdhenj të Umetit.

2 – Një skenar në të cilin mevludi konsiderohet bidat (risi), edhe nëse është pa ekzagjerim (ghul?) dhe vese (munkar?t). Kjo ndodh kur dikush beson se ka një virtyt të veçantë për atë ditë, ose ai beson se ka akte të veçanta të adhurimit, shpërblimi i të cilave është më i madh në atë ditë, ose beson se mbajtja e festimeve të tilla në këtë ditë të veçantë është e dëshirueshme në vetvete, njësoj si veprat e adhurimit që janë miratuar në një mënyrë të veçantë dhe janë të dëshirueshme në vetvete.

Është kjo kategori që u konsiderua e palejuar nga shumë dijetarë të mëdhenj të Umetit, siç janë Sheh el-Islam Ibn Tejmije dhe të tjerët.

Përgjigje kritikëve

Shkrimi im rreth mevludit shkaktoi disa reagime. Unë do t'i përmbledh ato më të rëndësishmet këtu duke iu përgjigjur çdo kundërshtimi:

Kundërshtimi i parë: Forma e mevludit të lejueshëm që keni përshkruar nuk ekziston askund.

Përgjigja: Nëse pranojmë për hir të argumentit që nuk ekzistojnë mevlude të tilla, atëherë kjo përgjigje shërben si korrigjuese për tubimet ekzistuese të mevludit

Kundërshtimi i dytë: Ekzistojnë mendime të ndryshme në lidhje me datën aktuale të lindjes së Profetit (a.s.). Si mund të veçohet kjo ditë në veçanti.

Përgjigja: Ky do të ishte një kundërshtim i vlefshëm nëse artikulli im do të kishte caktuar një virtyt të veçantë për të veçuar këtë ditë për një veprim të veçantë adhurimi. Pozicioni im nuk përmban një gjë të tillë. Mevludi në këtë rast është si caktimi i një dite të vitit për të kujtuar ndonjë çështje të rëndësishme.

Si rrjedhim, ndryshimi i mendimit për datën e saktë të lindjes së Profetit (a.s.) në vend se të jetë bazë për kritikën ndaj mevludit, në të vërtetë mbështet pozicionin që unë e kam shpjeguar [d.m.th. qendrimi im nuk synon t'i caktojë ndonjë virtyt të veçantë dates së lindjes së Profetit].

Sidoqoftë, mendimi më i fortë është se Profeti (a.s.) lindi në 12 të muajit Rabia el-Euel. Mendimi tjetër i fortë është se ai (a.s.) lindi në ditën e 9 të muajit Rabia el-Euel.

Mendimi i parë raportohet nga Ibn Abasi (r.a.) me një zinxhir autentik të transmetimit, dhe është pikëpamja e përgjithëshme e specialistëve të jetës së Profetit.

Mendimi i dytë është një përfundim i bazuar në ndërthurjen midis transmetimeve dhe llogaritjes astronomike të bërë nga astronomi Mahmud Pasha në librin e tij, “Netaixh el-efham fi tekum el-arab kable el-islam”.

Kundërshtimi i tretë: Si mund të bëjmë diçka që nuk e bënë as sahabët, as tabiinët dhe as tabi tabiinët (shokët e profetit, ndjekësit e tyre dhe ndjekësit e ndjekësve të tyre)? A e duam ne Profetin (a.s.) më shumë se ata?

Përgjigja: Ky është një kundërshtim i vlefshëm ndaj atyre që besojnë se mevludi është një veprim i veçantë adhurimi, i miratuar për atë ditë. Një besim i tillë do të ishte qartazi risi. Ndërsa për atë që e konsideron atë si një mjet të papërcaktuar (ma?la?a mursala) për të rritur ndërgjegjësimin për Profetin (a.s.), dhe për të rritur dashurinë për të, atëherë ky kundërshtim është i pakuptimtë. Dobia e përgjithshme (maslaha mursela) nuk kërkon që të ketë transmetime që janë praktikuar nga Selefët. Njerëzit (mes tyre edhe kundërshtarët e mevludit) gjithmonë kanë marrë dhe vazhdojnë të marrin çështje të lejuara si një mjet për të lehtësuar veprat e mira dhe veprimet e adhurimit, edhe pse ato nuk praktikoheshin nga Selefët.

Nëse dikush do t'i thoshte kundërshtarit të mevludit, “Minaret (për ezan) dhe mihrabët (për imamin) janë një risi. Nëse do të ishin të mira, Profeti (a.s.) do të na kishte paraprirë në kryerjen e tyre, “cila do të jetë përgjigja e tij?

Në të vërtetë, ai që kërkon që mjete të tilla të papërcaktuara të dobisë (maslaha mursela) në mënyrë që të jenë të vlefshme duhet të raportohen nga selefët, ai ka bërë risi në fe, ka kundërshtuar konsensusin e dijetarëve dhe ka rënë në kundërshtim.

Kundërshtimi i katërt: Kremtim i mevludit nënkupton ngjashmërinë (tashabbuh) me jobesimtarët, pasi ata festojnë ditëlindjen e Jezusit (krishtlindje), paqja qoftë mbi të.

Përgjigja: Jo çdo veprim i ngjashmërisë është ?aram, siç e kemi shpjeguar shumë herë. Profeti (a.s.) tha: “Ndryshoni nga hebrenjtë. Ata nuk kryejnë lutje duke pasur veshur meste (khuff) dhe as sandale. Sidoqoftë, ekziston konsensus që lutja zbathur është e vlefshme dhe nuk është e ndaluar.

Për më tepër, Profeti (a.s.) urdhëroi që të agjërojmë ditën e Ashurasë si mirënjohje ndaj Allahut për shpëtimin e Musait (Moisiut), paqja qoftë mbi të, në atë ditë nga Faraoni. Profeti (a.s.) tha: “Ne kemi më shumë të drejtë ndaj Musit sesa ata.” Ai nuk tha: “Ne nuk do të agjërojmë dhe nuk do të shprehim mirënjohje në mënyrë që të jemi të ndryshëm prej tyre.” Përkundrazi, ai e bënë të dukshme këtë mirënjohje si një mënyrë për t’i sfiduar ata, sepse ne kemi të drejtë më të madhe ndaj Musait se sa ata.

Pra, ngjashmëria me ta nuk na pengon të shprehim mirënjohje ndaj Allahut për shpëtimin e profetit të tyre, paqja qoftë mbi të, megjithatë një ngjashmëri e imagjinuar duhet të na pengojë të shprehim mirënjohje dhe lumturi në lindjen e Profetit tonë (a.s.)?

Të mos përmendim pastaj se një nga mënyrat më të mëdha për t’u dalluar nga mosbesimtarët është të tregojmë se ne e festojmë ditëlindjen e Pejgamberit (a.s.). Cili mund të jetë një ndryshim më i madh se ky, duke pasur parasysh se ata nuk besojnë tek profeti ynë?

Kundërshtimi i pestë: mos e hap derën e së keqes. Mevludi është haram sepse përbën një derë për ekzagjerime (ghulu) dhe praktika shirkut.

Përgjigja: Bllokimi i dyerve të së keqes arrihet duke hapur dyert për të mirë. Përfundimi që përmenda rreth mevludit hap një derë për të mirë dhe sqaron gabimet. Kjo është mënyra e duhur për të bllokuar shtigjet drejt së keqes, jo duke ndaluar çështjet e lejueshme me arsyetimin e “bllokimit të mjeteve të së keqes”. (sed el-dharai).

Është e detyrueshme për ne që të bllokojmë mjetet për të shpallur gjëra të ligjshme si të paligjshme bazuar në ekzagjerim dhe ekstremizëm ashtu si ne bllokojmë mjetet që dërgojnë në ekzagjerim (ghul?) për Profetin (a.s.).

Sidoqoftë, çështja është se risitë në mevlud janë të pranishme dhe mevlude që përmbajnë ekzagjerim [në lidhje me Profetin (a.s.)], përzierje të pakontrolluar ndërmjet gjinive dhe vese të tjera, vazhdojnë të ekzistojnë. Qëndrimi im shërben për të treguar rrezikun e tyre dhe se ata janë në kundërshtim me Sheriatin, ashtu siç tregon mënyrën e vlefshme të festimit të lindjes së Profetit (a.s.)

Kundërshtimi i gjashtë: Deklaratat e dijetareve që e shpallin mevludin risi apo e ndalojnë kremtimin e tij.

Përgjigja: Ka shumë më shumë deklarata të dijetarëve që e kanë lejuar mevludin me kushte të caktuara. Ixhtihadi i një dijetari nuk kundërshtohet me ixhtihadin e një dijetari tjetër. Pika e referencës është provë: “Kur nuk pajtoheni me diçka, përcillenit te Zoti dhe i Dërguari po qe se besoni Zotin dhe Ditën e Fundit. Kjo është zgjidhja më e mire dhe e bukur.”[4:59]

Më në fund, unë kam sqaruar se e respektoj mendimin e atyre që e ndalojnë krejt, me kusht që ata të respektojnë mendimin e atyre që e lejojnë atë me kushte. Nëse ata e censurojnë pozicionin kundërshtues, atëherë ky qëndrim i tyre është në vetvete i denjë për censurim, sepse ata kanë shkuar

kundër konsensusit përfundimtar të dijetarëve se nuk ka censurë në çështjet e ixhtihadit të vlefshëm.

Përktheu: Rezart Beka

.

[\[1\]](#)

Date Created

09/11/2019

Author

hatem-el-auni